



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. DPK/DMP	Nr. i treg. 03-4568/12
Nr. i treg. 01	Data 30.12.2012
Nr. i treg. 01	
Nr. i treg. 01	



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË GJAKOVË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U ĐAKOVICI/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN GJAKOVË**

**Nr.regj.04-264/10**

**GJYKATA KOMUNALE E KUNDËRVAJTJES NE GJAKOVE**, Gjyqtarja *Diana Sina*, duke vendosur ne proceduren kundervajtese kunder të pandehurit Mazllom Kumnova nga Gjakova, per shkak të vepres kundervajtese nga nga neni 16.par.1.1 të Ligjit për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë, e në bazë të nenit 73,75, 110, 195 dhe 198 al 1 pika 7, neni 27 al.4 të Ligjit mbi kundërvajtje me dt.12.12.2012, muarr këtë,

**A K T V E N D I M**

**PEZULLOHET** kërkesa për iniciimin e procedurës kundervajtese kundër të pandehurit Mazllom Kumnova nga Gjakova, si U.D.Prodekan I Fakultetit të edukimit –dega në Gjakovë, - se është shkaktuar parashkrimi për zhvillimin e procedurës kundervajtëse.

Konforme nenit 198.al.1 pika 7 te LMK.

**A r s y e t i m**

Sipas kërkeses së Agjencionit kundër korrupsionit në Prishtinë, nr.01/2315/10 dt.08.06.2010, është filluar procedura kundervajtese kunder të pandehurit, për shkak të kundervajtjes nga Ligji për deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publikë.

Gjykata me rastin e shiqimit të shkresave të lëndës konstatoi se edhe pas ndërmjes së veprimve nga kjo Gjykat ,shifet se ka ardh deri te parashkrimi absolut I ndjekjes me dt. 08.06.2012, për shkak se vepra kundervajtëse është kryer me dt.08.06.2010,në këtë rast kanë kaluar dy vjet nga data kurë është kryer kundërvajtja, pasi që lënda ka qenë te ish Gjyqtarja për kundërvajtje, dhe për këtë arsye është ardh gjër të parashkrimi apsult , konform nenit 27.al.4 të LMK.

Duke u bazuar në parashtrimet e mesiperme , Gjykata konforme nenit 198., al.1 pika 7 te Ligjit mbi kundervajtjet, PEZULLOI proceduren lidhur me këtë qeshtje.

Per sa u tha me lart u vendos si ne dispozitiv te ketij aktvendimi.

Kunder ketij aktvendimi mund te paraqitet ankes ne afat prej 8 ditesh, nga dita e marrjes se ketij aktvendimi dhe ketë Gjykates së Lart të kundërvajtjes në Prishtine, përmes kësaj Gjykate.

Aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës .

**GJYKATA KOMUNALE E KUNDERAJTJES NE GJAKOVE.**

**Nr.regj.04-264/10, date 12.12.2012**

